

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Gusht 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
	19.08.2025	Unë, J.L gazetar në “Syri Televizion””, në bazë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, po ju dërgoj kërkesën për informacion me pyetjet si më poshtë vijon: Duke u nisur nga situata e zjarreve në vendin tonë do të t`ju lutesha të dërgonit të dhënat e kërkuara sipas pyetjeve të mëposhtme: Sa është numri total i zjarreve të rënë në Shqipëri për periudhën 1 janar 2025 deri në 19 gusht 2025? Cilat janë bashkitë më të prekura (ju lutem të dhënat për sipërfaqet e djegura) në vendin tonë? Nëse keni, sa automjete zjarrfikëse kanë secila bashki, punonjës zjarrfikës dhe mjete mbështetëse për mbrojtjen nga zjarret? Sa është numri i banesave të djegura (ju lutem përcaktoni për çdo fshat në çdo bashki të vendit)? Në përlllogaritjet paraprake, në vlerë financiare, sa është dëmi i shkaktuar nga zjarret përfshi: dëmet në banesa, dëmet në sipërfaqe pyjore, monumente natyre, kulture, objekte të rëndësishë së veçantë etj? Si do të bëhet dëmshpërblimi për banorët e prekur nga zjarret në vendin tonë? Sa helikopter dhe avion kanë asistuar për shuarjen e zjarreve në Shqipëri përgjatë muajit korrik dhe gusht 2025?	21.08.25	Pershendetje, Ne vijim gjeni përgjigje mbi pyetjet e gazetarit. Faleminderit. Sa është numri total i zjarreve të rënë në Shqipëri për periudhën 1 janar 2025 deri në 19 gusht 2025? Sipas raportimeve nga bashkitë dhe prefekturat, numri total i zjarreve të regjistruara gjatë periudhës 1 Janar – 19 Gusht 2025 në territorin e Shqipërisë është 2005 vatra zjarri. Është e rëndësishme të theksohet se kjo shifër përfshin jo vetëm zjarret masive në pyje dhe sipërfaqe natyrore, por edhe zjarret urbane të vogla në banesa, oborre dhe ambiente të tjera, të cilat menaxhohen në nivel vendor dhe nuk paraqesin rrezik të konsiderueshëm për komunitetet.	E plote	Nuk ka

		Duke u nisur nga deklaratat e Ministrit të Mbrojtjes, do të donim të dinim dhe të na vinit në dispozicion procedurën e prokurimit për blerjen e avionëve zjarrfikës?	Cilat janë bashkitë më të prekura (ju lutem të dhënat për sipërfaqet e djegura) në vendin tonë? Sipas të dhënave të grumbulluara në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, e administruar sipas VKM-së Nr. 345, datë 26.05.2022, dhe bazuar në raportimet mujore të bashkive, bashkitë më të prekura nga zjarret në vendin tonë, duke përfshirë sipërfaqet e djegura, janë si më poshtë: Bashkia Delvinë; Bashkia Finiq; Bashkia Himarë; Bashkia Gramsh; Bashkia Selenic etj. Të dhënat mbi sipërfaqet e djegura grumbullohen direkt nga grupet e vlerësimit të bashkive dhe përpunohen në mënyrë të vazhdueshme në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, duke siguruar informacion të përditësuar mbi dëmet materiale dhe natyrore.	
--	--	---	--	--

			Nëse keni, sa automjete zjarrfikëse kanë secila bashki, punonjës zjarrfikës dhe mjete mbështetëse për mbrojtjen nga zjarret? Sipas Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ushtron rol koordinues, drejtues, teknik dhe mbikëqyrës në fushën e mbrojtjes civile, por nuk zotëron kapacitete operacionale vetjake. Funksioni i saj është të bashkërendojë dhe koordinojë angazhimin e forcave operacionale që përcaktohen në ligj (Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, Shërbimi i MZSH-së, Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe shërbimi vullnetar). Ndërkohë, në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, shërbimet zjarrfikëse organizohen dhe administrohen nga	
--	--	--	--	--

			bashkitë, përmes drejtorive ose sektorëve të posaçëm. Çdo bashki ka detyrimin ligjor të: sigurojë mbulimin e territorit të saj me stacione zjarrfikëse, garantojë personel të trajnuar, automjete zjarrfikëse dhe pajisje mbështetëse, administrojë numrin e punonjësve, automjeteve dhe mjeteve të tjera të MZSH-së në territorin e saj. Në nivel qendror, evidencat zyrtare dhe mbikëqyrja e shërbimit zjarrfikës mbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, e cila është përgjegjëse për organizimin, funksionimin dhe pajisjen e këtij shërbimi. Sa është numri i banesave të djegura (ju lutem përcaktoni për çdo fshat në çdo bashki të vendit)? Në përputhje me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen	
--	--	--	---	--

			civile”, neni 30, pika gj, është bashkia ajo që ka përgjegjësinë ligjore për kryerjen e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e saj, përfshirë: përcaktimin e numrit të banesave të djegura, vlerësimin e nevojave për përbalimin e tyre, dhe dëmshpërblimin e shtetasve të prekur. Prandaj, informacioni për numrin e banesave të djegura (i detajuar sipas fshatit dhe bashkisë përkatëse) do të plotësohet dhe konfirmohet nga bashkitë mbi bazën e verifikimeve në terren. Në përlllogaritjet paraprake, në vlerë financiare, sa është dëmi i shkaktuar nga zjarret përfshi: dëmet në banesa, dëmet në sipërfaqe pyjore, monumente natyre, kulture, objekte të rëndësishme të veçantë etj? Sipas Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”,	
--	--	--	--	--

			neni 30, pika gj, përgjegjësia për: vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblimi min e shtetasve të prekur, i takon bashkive. Kjo përfshin edhe përlllogaritje n e vlerës financiare të dëmeve, që mbulon: dëmet në banesa, dëmet në sipërfaqe pyjore, monumente natyre, kulture, si dhe objekte të rëndësisë së veçantë. Pasi bashkitë të finalizojnë verifikimet dhe përlllogaritjet përkatëse, të dhënat konsolidohen dhe administrohen në nivel qarku dhe më pas do të dërgohen në Agjencinë Kombëtare Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi. Si do të bëhet dëmshpërblimi për banorët e prekur nga zjarret në vendin tonë? Sipas nenit 41 të Ligjit nr. 45/2019	
--	--	--	--	--

			“Për Mbrojtjen Civile”, dëshmipërblimi për banorët e prekur nga zjarret në vendin tonë bëhet në këtë mënyrë: Shteti shqiptar përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë, ndërsa vetë bashkitë e prekura përdorin fondet e dedikuara për mbrojtjen civile për kompensimin. Nëse këto fonde nuk janë të mjaftueshme, bashkitë planifikojnë kompensimin për vitin pasardhës. Kur dëmet tejkalojnë 8% të buxhetit të bashkisë, kompensimi kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC). Procedura e Kompensimit nga Dëmet e Fatkeqësive Evidentimi i dëmeve Kryetari i Bashkisë nëngre Grupin e Konstatimit. Ky grup bën inventarizimin e dëmeve (banesa, orendi, infrastrukturë, biznese, bujqësi, blegtori, objekte sociale-kulturore). Vlerësimi i dëmeve Me urdhër të Kryetarit të		
--	--	--	--	--	--

			Bashkisë ngrihet Grupi i Vlerësimit. Grupi vlerëson dëmet sipas natyrës së fatkeqësisë dhe plotëson formularët. Çmimet referohen nga ministritë dhe institucionet përgjegjëse (p.sh. Ministria e Bujqësisë, Tatimet). Dokumentacioni Bashkia përgatit listat përmbledhëse dhe mbledh dokumentet: Certifikatë familjare Kopje dokumenti identifikimi Në rast humbje jete, kërkohet edhe certifikata e vdekjes dhe raporti mjeko-ligjor. Vlerësimi financiar Për banesa të shkatërruara totalisht përdoren kostot mesatare të ndërtimit (Enti Kombëtar i Banesave). Për dëme të pjeshme, përdoren çmimet e punimeve sipas tregut. Hartohen preventivat dhe planimetritë. Miratimi dhe financimi Bashkia mbulon dëmet me fondin e mbrojtjes civile, 4% i cili i vjen në formën e një fondi	
--	--	--	---	--

			të dedikuar cdo vit. Nëse fondet nuk mjaftojnë, kompensimi planifikohet për vitin pasardhës. Nëse dëmi tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, kërkesa kalon në Prefekturë dhe më pas në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC). Financimi mund të bëhet nga buxheti i Emergjencave Civile ose me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Sa helikopter dhe avion kanë asistuar për shuarjen e zjarreve në Shqipëri përgjatë muajit korrik dhe gusht 2025? Gjatë muajve korrik dhe gusht 2025, Shqipëria është përballur me një valë intensive zjarresh, duke mobilizuar të gjitha kapacitetet e saj kombëtare për shuarjen e tyre, si në nivel tokësor ashtu edhe ajror. Përveç forcave vendase, në terren kanë qenë të angazhuara edhe njësitë ndërkombëtare si pjesë e mekanizmit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen Civile,	
--	--	--	---	--

			duke siguruar mbështetje të specializuar dhe efikase në neutralizimin e vatrave aktive. Pjesëmarrësit dhe kapacitetet ajrore ishin: Forcat e Armatosura të Shqipërisë: 4 helikopterë. Hungaria: 2 helikopterë Cougar. Kroacia: 1 avion Canadair. Çekia: 1 helikopter Black Hawk. Sllovakia: 1 helikopter Black Hawk. Arabia Saudite: 2 helikopterë Black Hawk. Italia: 2 avionë Canadair. Greqia: 2 avion PZL. Suedia: 2 avion FireBoss Në total, 10 helikopterë dhe 7 avionë kanë operuar në terren, duke garantuar një reagim të koordinuar dhe efektiv ndaj zjarreve, dhe duke mbrojtur komunitetet dhe territorin shqiptar. Duke u nisur nga deklaratat e Ministrit të Mbrojtjes, do të donim të dinim dhe të na vinit në dispozicion procedurën e	
--	--	--	---	--

			prokurimit për blerjen e avionëve zjarrfikës? . Përsa i përket deklaratës së Ministrit të Mbrojtjes lidhur me blerjen e avionëve zjarrfikës, informacioni mbi procedurën e prokurimit mund të merret dhe verifikohet përmes Zyrës së Medias së Ministrisë së Mbrojtjes. Ju mund të dërgoni kërkesën tuaj atje, dhe stafi përkatës do t’ju sigurojë të gjitha të dhënat e detajuara mbi procesin, në përputhje me ligjin.		
--	--	--	--	--	--